

ÇKA ËSHTË BOMBOLA E GAZIT?

Bombola e gazit është enë bartëse e gazit (apo gaz i lëngëzuar i naftës – GLN) e cila është nën presion.

LLOJET E BOMBOLAVE

Ekzistojnë bombola gazi me madhësi dhe forma të ndryshme.

Ato mund të jenë bombola:

- Për një përdorim,
- Për kamping,
- Për amvisëri,
- Gastronomi etj

HAPAT QË DUHET NDËRMARRË ME RASTIN E NDËRRIMIT TË BOMBOLËS SË GAZIT

- Të shikohet data e afatit të vlefshmërisë të shqyrtimit e stampuar në bombolë,
- Para ndarjes së bombolës së zbrazët të mbyllet ventili mbyllës,
- Para lidhjes së bombolës të mbushur në harxhues, të sillet kapaku mbrojtës (në drejtim të lëvizjes të akrepave të orës),
- Të ndërrohet dihtungu në bulonin lidhës,
- Pas lidhjes së bombolës me rregullator të presionit, hapet ventili i bombolës dhe me shkumë sapuni të vërtetohet nëse ka rrjedhje (në lidhje, rregullator dhe në gypin fleksibil),
- Në rast të rrjedhjes, të mbyllet ventili i bombolës dhe të eliminohet shkaktari i rrjedhjes.



Kahja e mbylljes së bombolës

- Në rastet kur mbyllja e ventilit është e pamundur dhe bombola kaplohet nga zjarri të mbulohet me gjësende të lagura (batanije apo të ngjashme),



- Gypi fleksibel nuk duhet të ketë gjatësi më të madhe se 1 metër. Duhet të kontrollohet rregullisht për dëmtime ose plasaritje. Të zëvendësohet brenda 5 vjetësh nga data e shënuar në gyp, nëse prodhuesi nuk kërkon ndryshe,
- Të njoftohen anëtarët e tjerë në shtëpi/lokal mbi përdorimin e bombolës të gazit dhe veprimeve në rast të rrezikut,
- Bombolat e gazit duhet të ruhen, transportohen dhe përdoren vetëm kur janë në pozicion vertikal,
- Mos mbani kurrë një bombole të plotë apo të zbrazët në një makinë të mbyllur, parking të automjeteve, bodrum, dhomë të fjetjes, etj.,
- Mos e hedh atë në mbeturina,
- Bombola e zbrazët është e rrezikshme njësoj si bombola plotë,